

V E N D I M

Nr.28, datë 21.1.1999

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.730, DATË 19.11.1998 “PËR MIRATIMIN E RRITJES SË KUOTËS SË ANËTARËSIMIT NË FONDIN MONETAR NDËRKOMBËTAR”

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.730, datë 19.11.1998, pika 2 ndryshohet si vijon:

“Shtesa e kuotës, prej 13 400 000 (trembëdhjetë milionë e katërqind mijë) SDR-she, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të mbulohet me kredi të marra nga Fondi Monetar Ndërkombëtar ose të sigurohet me mjete të përshtatshme. Kjo shtesë nuk do të jetë element i shpenzimeve të buxhetit të shtetit.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko